



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 313/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shemsi Maksuti, koordinatori i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Skenderaj, paraqitur kundër kryesuesit të VV 2107/b, në Skenderaj, për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pas afatshme ankesa e Shemsi Maksuti, koordinatori i PDK-së, dega në Skenderaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.06.2014, nga Shemsi Maksuti, koordinatori i subjektit politik PDK në Skenderaj, në të cilën thekson se kërkojmë nga PZAP-i që të bëjë përmisimin e Formularit për Përputhjen e të dhënave dhe Rezultateve të VV Nr. 2107/b, 02r, qendra e votimit në Polac të komunës së Skenderajt, pasi në të mungon numri i votave të subjektit politik PDK. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se shkelja në këtë VV ka ndodhur me datë 08.06.2014 në orën 22:27 nga kryesuesi Musa Aliu, duke harruar ti vendos votat e subjektit politik PDK në FPR, me të cilën deklarata e kryesuesit dhe faqja e FPR-së iu është bashkangjitur ankesës

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme ngase afati për të parashtruar ankesë në PZAP është përcaktuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24*

orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”. Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP me datë 09.06.2014 në ora 20:16, që nënkupton se është pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërshënuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 313/2014 më datën 11.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.